

NURIDIN AHMETI**50 VJET “GJURMIME ALBANOLOGJIKE”
SERIA E SHKENCAVE HISTORIKE****Hyrje**

Krahas revistave të njohura shkencore, kulturore e letrare, që filluan të dalin në Prishtinë “Përparimi”¹ dhe “Jeta e re”², pas Luftës së Dytë Botërore, një vend me rëndësi zë edhe revista “Gjurmime albanologjike”. Në fakt, kjo revistë rrugëtimin e filloi nga viti 1962, kur edhe u botua numri i parë, që asokohe ishte organ i Katedrës së Albanologjisë të Fakultetit Filozofik të Prishtinës. Kryeredaktori i parë i kësaj reviste ishte profesori i nderuar Idriz Ajeti³, ndërsa redaksia përbëhej nga Ali Hadri, Enver Gjerqeku, Shefqet Pllana dhe Idriz Ajeti. Pra, kjo revistë shkencore filloi të botohej dy vjet pas hapjes së Fakultetit Filozofik në Prishtinë më 1960. Shkrimet në këtë revistë botoheshin në dy gjuhë: në shqip dhe në serbisht. Punimet në numrin e parë, ishin nga fusha e gjuhësisë, historisë dhe folklorit. Ato shoqëroheshin edhe me nga një rezymë në gjuhë të huaj si: gjermanisht, frëngjisht e rusisht. Në numrin e parë me punime kontribuuan studiuesit e vendit, si: Idriz Ajeti, Hasan Kalesshi, Ali Hadri, Shefqet Pllana, Hilmi Agani, Anton Çetta, Haxhi Krasniqi e Syrja Pupovci dhe të huaj, si: Danilo Barjaktarević, Miodrag Šijaković, Mirko Barjaktarević, P.Ž. Petrović, Dragutin Mićović, Milan Budimir dhe Milivoj Pavlović.⁴ Numri i parë i kësaj reviste u shtyp në shtypshkronjën

¹ Revistë shkencore dhe publicistike. Numri i parë doli në muajin maj të vitit 1946 dhe vazhdoi deri në vitin 1986. Revista u botua në Prishtinë. Ishte revista e parë kulturore e shkencore në vendin tonë pas Luftës së Dytë Botërore. *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, vëll. III (N-Zh), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2009, f. 2008.

² Revista e parë letrare në vendin tonë. Numri i parë i saj doli më 1949 në Prishtinë. Del çdo dy muaj. Boton të gjitha zhanret e krijimtarisë letrare. *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, vëll. II (H-M), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2008, f. 1066.

³ Idriz Ajeti ishte kryeredaktor nga numri një i vitit 1962, deri në numrin 1-2 të vitit 1970.

⁴ Përveç emrave të lartpërmendur, deri më 1970, me kontribute shkrimore në revistë hasim edhe këta studiues: Milan Budimir, T. P. Vukanović, Žarko Muljačić, Živko

“Rilindja” në Prishtinë. Revista nuk u botua rregullisht. Në vitin 1965 u botua një vëllim, numri 2, në vitin 1966 doli një vëllim, numri 3 dhe me dy emra të rinj në redaksi, Mark Krasniqi dhe Vojislav Dančetovićin.

Me rastin e rithemelimit të Institutit Albanologjik, më 1967, revista filloi të botohet si organ i këtij institucioni. Në vitin 1968, u botuan dy numra të kësaj reviste, me kryeredaktor Idriz Ajetin, ndërsa anëtarë të redaksisë ishin: Mark Krasniqi, Hasan Kaleshi, Fehmi Agani, Rexhep Qosja, Zekeria Cana dhe Idriz Ajeti.⁵ Me të njëjtin staf të redaksisë u botuan edhe dy numra në vitin 1969. Në vitin 1970 doli në dritë botimi tjetër, i cili përmbante dy numra (1 dhe 2), ndërkohë që në përbërje të redaksisë u shtuan edhe dy emra të rinj, Syrja Pupovci dhe Jashar Rexhepagiqi. Nga viti 1971, revista profilizohet në tri seri: “Gjurmime albanologjike” - seria e shkencave gjuhë dhe letërsi, seria e shkencave folklor dhe etnologji si dhe seria e shkencave historike.

Gjatë periudhës 1962-1970, kemi vetëm një studiues nga Shqipëria, Androkli Kostallarin, i cili prezantohet me punimin “Rruga e formimit të gjuhës sonë të përbashkët letrare”, në numrin 2 të vitit 1969.

Ka disa arsye që na kanë shtyrë t’i bëjmë një vështrim kësaj ndërmarrjeje shkencore, por dy janë më kryesoret:

Së pari, është revista e parë shkencore të shqiptarët e ish Jugosllavisë që merret ekskluzivisht me studime albanologjike pas Luftës së Dytë Botërore dhe e botuar nga një institucion shkencor; dhe *së dyti*, kjo revistë këtë vit mbush pesëdhjetë vjet nga profilizimi i saj, siç e theksuam edhe më lart.

“Gjurmime albanologjike” - seria e shkencave historike

Revista “Gjurmime albanologjike” - seria e shkencave historike, e cila si e profilizuar filloi të dilte nga viti 1971, punën e nisi me kryeredaktorin e ri, studiuesin e historisë Ali Hadri⁶, kurse në redaksi

Avramovski, Mihailo Pavlović, Wilfred Fiedler, Radomir Ivanović, Alois Schmaus, Eric P. Hamp, Ivan Božić, Ismail Eren, Vuk Vinaver, Karl Treimer, Olga Zirojević, Stjepan Antoljak, Robert Schwanke, Aleksander Matkovski, Bogumil Hrabak, Hans-Jürgen Kornrumpf, Nikolae Ciachir, Aleksandar Stipčević, Aleksandar Petrović, Miloš Bogdanović, Christian Gut.

⁵ Nga numri dy i vitit 1968, revista kishte edhe sekretarin e redaksisë. Sekretar i parë i redaksisë ishte Zekeria Cana, i cili vazhdoi punën deri në numrin 1/1971.

⁶ Ali Hadri (1/1971-IV-V/1974/75), Skënder Rizaj (VI/1976-14/1984), Shukri Rahimi (15/1985), Xheladin Shala (16/1986-41-42/2011/12), Lulëzim Lajçi (43/2013-48/2018), Naser Ferri (49/2019).

bënin pjesë studiuesit: Syrja Pupovci, Jashar Rexhepagiqi, Zekeria Cana dhe Ali Hadri. Sekretar i redaksisë ishte Zekeria Cana.⁷ Përveç kontributeve historiografike kjo seri përmbante edhe studime, recensione dhe artikujt të ndryshëm nga fusha e arkeologjisë.

Revista, që nga numri i parë, ishte profilizuar në rubrika të caktuara të rregullta, si: studime e artikuj, kritika e recensione, por nuk mungonin as rubrikat e tjera, të cilat i gjejmë gjatë këtij rrugëtimi pesëdhjetëvjeçar, sipas përmbajtjes së tyre, sikundër ishin: materiale shkencore, nekrologji, kronika shkencore, diskutime etj.

Duhet theksuar se rubrika e kritikave dhe e recensioneve, ishte mjaft e pasur. Studimet e botuara që kishin në fokus albanologjinë, trajtonin posaçërisht fushën e historisë dhe të arkeologjisë, të cilat prezantoheshin në mënyrë koncize. Gjithashtu, studimet që botoheshin në botën perëndimore, veçanërisht ato për historinë shqiptare në gjuhën gjermane, gjetën vend në faqet e kësaj reviste përgjatë tërë dekadës së parë të jetës së saj. Këtu duhen veçuar për prezantime të shpeshta studiuesit Zef Mirdita, Hasan Kaleshi, Skënder Rizaj etj.

Gjatë pesëdhjetë vjetëve anëtarë të redaksisë së kësaj reviste ishin këta studiues: Ali Hadri, Aleksandër Stipçeviqi, Syrja Pupovci, Jashar Rexhepagiq, Zekeria Cana, Skënder Rizaj, Zef Mirdita, Sadulla Brestovci, Shukri Rahimi, Novica Rakoçeviq, Tahir Abdyli, Hakif Bajrami, Bernard Stulli, Exhlale Salihu, Shkëlzen Raça, Xheladin Shala, Daut Bislimi, Lulëzim Lajçi, Muharrem Dezhgiu, Lush Culaj, Qerim Dalipi, Memli Krasniqi, Nehat Krasniqi, Michael Schmid-Neke dhe Anton Panchev.

Barra më madhe gjatë këtij pesëdhjetëvjeçari, që kjo revistë të botohej rregullisht ishte mbi punonjësit shkencorë të brendshëm, të cilët pavarësisht sfidave të kohës, botuan kohë pas kohe, emrat e të cilëve janë: Zekeria Cana, Rexhep Qosja, Mehmet Halimi, Ymer Jaka, Sadri Fetiu, Muhamet Pirraku, Sadullah Brestovci, Exhlale Dobruna-Salihu, Naser Ferri, Skënder Gashi, Xheladin Shala, Ibrahim Goçi, Shefkije Islamaj, Flamur Hadri, Rexhep Doçi, Mehmet Ahmetaj, Daut Bislimi, Shkëlzen Raça, Lulëzim Lajçi, Lush Culaj, Hysen Matoshi, Ylber Hysa,

⁷ Me punën e sekretarit të redaksisë, vazhduan këta studiues: Sadulla Brestovci (2/1972-IX/1979), Xheladin Shala (X/1980-14/1984), Naser Ferri (15/1985), Shkëlzen Raça (16/1986-27/1997), Lulëzim Lajçi (28-29/1998/99-41-42/2011/12), Nuridin Ahmeti (43/2012).

Zymer Neziri, Nehat Krasniqi, Memli Krasniqi, Nuridin Ahmeti, Begzad Baliu, Shpend Avdiu, Arianit Buqinca, Sadik Mehmeti, Zana Hoxha.

Që kjo revistë të dilte sa më e plotë, ndihmesë me shkrimet e tyre dhanë edhe studiues nga Shqipëria si: Aleks Buda, Selami Pulaha, Selim Islami, Luan Malltezi, Kristaq Prifti, Gazmend Shpuza, Petrika Thëngjilli, Lefter Nasi, Hamit Boriçi, Ana Lalaj, Pëllumb Xhufi, Marenglen Verli, Hysen Kordha, Rudina Shpuza, Esat Bilali, Muharrem Dezhgiu, Hysni Myzyri, Fatmira Musaj, Uran Butka, Shyqyri Hysi, Avdyl Sula, Leonora Shkurtaj, Hamit Kaba, Pranvera Dibra, Lavdosh Ahmetaj, Isa Halilja, Kasëm Biçoku, Esilda Luku, Hilë Lushaku, Jani Sota, Hasan Bello, Ermal Baze, Alvin Saraçi, Klodian Gjoni, Ilia Karanxha, Sokol Gjermëni, Jorina Verli, Etleva Smaçi, Ilirjana Kaceli, Jaho Cana dhe Sali Kadria. Këtu nuk duhen anashkaluar as studiuesit tanë arbëreshë, sikundër janë Aleksandër Stipçeviqi dhe Zef Kiamonte.

Nuk kanë munguar as studiuesit e huaj, si: Gelku Maksutovici, Vuk Vinaver, Marin Zaninović, Vinko Ivančević, Zhivko Avramovski, Tone Knez, Aleksandar Petrović, Millosh Bogdanović, Gjorgje Mikić, Nicola Ciachir, Haris Silajxhiq, Sreten Martinović, Stjepan Antoljak, Niksha Petriq, Millan Ivanisheviq, Györgu Dániel, Włodzimierz Pajakowski, Ivan Pederin, Josip Luetiq, Safet Nurković, Branisllav Millutinović, Kristian Gut, Nexhip Alban, Efthim Dodona, Connie Christo, Wojciech Szczepanski, Odette Marquet, Katerina Todoroska, Sherbo Rastoder, Kristina Džin, Aleksandar Atanasovski, Petr Iskenderov, Mithad Kozlliciq, Michael Schmid-Neke etj.

Kur trajtojmë studiuesit e huaj duhet theksuar se, në kuadër të bashkëpunimit dhe afirmimit të albanologjisë në arenën ndërkombëtare, në vitin 1985, Instituti Albanologjik filloi me nxjerrjen e serisë së “Gjurmimeve albanologjike” në gjuhë të huaj, si në gjuhën frënge, me titullin “Recherches albanologique”, si dhe ndonjë tekst në gjuhën gjermane, e cila vazhdoi deri në vitin 1987. Pra, dalin gjithsej katër numra. Në këto numra i prezantuan punimet nga fusha e historisë dhe e arkeologjisë studiuesit: Aleksandër Stipçeviqi⁸, Zef Mirdita⁹, Exhlale

⁸ Aleksandar Stipčević, “Origine et développement du symbolisme des Ilyriens”, *Recherches albanologique*, nr. 2, Institut Albanologique de Prishtina, Prishtina: 1985, f. 169-210; *po ai*, “Le serpent comme gardien du tombeau”, *Recherches albanologique*, nr. 3, Institut Albanologique de Prishtina, Prishtina: 1986, f. 145-151.

⁹ Zef Mirdita, “Contribution à l’étude de la religion et des cultes des Dardaniens à l’époque préromaine”, *Recherches albanologique*, nr. 1, Institut Albanologique de

Dobruna-Salihu¹⁰, Zekeria Cana¹¹, Sadullah Brestovci¹², Jahja Drançolli¹³, Marjan Prenkaj.¹⁴ Në vitin 2015 tradita e nxjerrjes së “Gjurmimeve albanologjike” në gjuhë të huaj vazhdon, veçse kësaj radhe, numri i parë do të botohet në gjuhën angleze me titullin “Albanological researches”. Studimet nga fusha e historisë dhe e arkeologjisë në këtë numër do të përfaqësohen nga studiuesit: Aleks Buda, Zekeria Cana, Shkëlzen Raça, Xheladin Shala, Lulëzim Lajçi, Ana Lalaj, Naser Ferri, Exhlale Dobruna-Salihu, Lush Culaj dhe Memli Krasniqi. Duke pasur parasysh prirjet bashkëkohore të publikimit të revistave edhe në platforma digjitale, drejtuesit e Institutit Albanologjik kanë bërë hapa konkretë, duke u anëtarësuar në Central and Eastern European Online Library (CEEOL).

Përveç anëtarëve të redaksisë dhe punonjësve shkencorë të Degës së Historisë të Institutit Albanologjik, ndihmesë të çmueshme me shkrimet e tyre dhanë edhe bashkëpunëtorët e jashtëm, si: Tahir Abdyli, Ramiz Abdyli, Fehmi Agani, Shemsi Ajvazi, Shaban Hashani, Zija Bylykbashi, Selim Daci, Ali Dida, Esat Hasakuka, Izber Hoti, Muhamet Shatri, Nahit Ipçiu, Masar Kodra, Hivzi Islami, Muhamet Tërnavë, Feti Mehdiu, Ali Jakupi, Sherafedin Hoxha, Shpresa Hoxha, Islam Dobra, Emin Pllana,

Prishtina, Prishtina: 1984, f. 139-159; *po ai*, “Die wirtschaftliche und gesellschaftliche Verhältnisse des Zentralgebietes der Dardanien in der Antike”, *Recherches albanologique*, nr. 2, Institut Albanologique de Prishtina, Prishtina: 1985, f. 211-225; *po ai*, “La romanisation et le problème du substrat de la Dardanie à l’époque préromaine”, *Recherches albanologique*, nr. 3, Institut Albanologique de Prishtina, Prishtina, 1986, f. 153-159.

¹⁰ Exhlale Dobruna-Salihu, “Une stèle funéraire de la Plaine de la Kossova”, *Recherches albanologique*, nr. 1, Institut Albanologique de Prishtina, Prishtina: 1984, f. 161-168.

¹¹ Zekeria Cana, “L’insurrection générale albanaise de l’an 1912”, *Recherches albanologique*, nr. 1, Institut Albanologique de Prishtina, Prishtina: 1984, f. 169-198; *po ai*, “Attitude de la social-démocratie serbe face à l’indépendance nazinal albanaise”, *Recherches albanologique*, nr. 3, Institut Albanologique de Prishtina, Prishtina: 1986, f. 161-183.

¹² Sadullah Brestovci, “Le Mouvement national albanais et les relations entre Albanais, Serbes et Monténégrins pendant la crise orientale”, *Recherches albanologique*, nr. 4, Institut Albanologique de Prishtina, Prishtina: 1987, f. 163-185.

¹³ Jahaj Drançolli, “Présence des Albanais à Raguse entre le XIII^e et le XV^e siècles”, *Recherches albanologique*, nr. 4, Institut Albanologique de Prishtina, Prishtina: 1987, f. 115-137.

¹⁴ Marjan Prenkaj, “Quelques aspect de la résistance de la Ligue albanaise de Prizren aux clauses du Congrès de Berlin 1878-1881”, *Recherches albanologique*, nr. 4, Institut Albanologique de Prishtina, Prishtina: 1987, f. 139-161.

Iljaz Rexha, Riza Rexha, Riza Sadiku, Ejup Statovci, Gjyltekin Shehu, Bedrush Shehu, Edi Shukriu-Hoti, Sabit Uka, Marjan Prenkaj, Jahja Drançolli, Ali Vishko, Qamil Gexha, Vebi Xhemaili, Eqrem Zenelaj, Sabri Rexha, Fehmi Rexhepi, Gazmend Rizaj, Masar Rizvanolli, Limon Rushiti, Latif Mulaku, Muhamed Mufaku, Muhamet Shukriu, Engjëll Sedaj, Aliriza Selmani, Sylë Dreshaj, Qerim Lita, Muhamet Mala, Emine Arifi-Bakalli, Nikë Ukgjini, Fejzulla Shabani, Sulltane Kojçini-Ukaj, Zeqirja Idrizi, Fahredin Shabani, Isa Bicaj, Haki Kasumi, Sabile Keçmezi-Basha, Bedri Muhadri, Enver Hoxhaj, Xhoana Perkaç, Ajten Ardel, Ibrahim Gashi, Halim Purellku, Tefik Raka, Fehmi Pushkolli, Muharrem Qafleshi, Fehari Ramadan, Alban Dobruna, Bektesh Vidishiçi, Adem Murati, Jakup Krasniçi, Mehmet Gjoshaj, Nail Draga, Fadil Bytyçi, Hivzi Muharremi, Rrustem Buzhala, Hamdi Fazliu, Hysen Ibra, Sami Gashi, Enis Halimi, Isuf Ahmeti, Sylë Ukshini, Sadik Krasniçi, Fitim Rifati, Luan Tetaj, Dëfrim Gashi, Teuta Shala, Emine Kalaja, Mrika Limani, Haxhi Ademi, Arbër Hadri, Arben Hajdari, Izet Miftari, Mustafë Haziri, Milazim Elshani, Lulzim Nika, Kosovar Alija, Skënder Zhitia, Skënder Lutfiu, Kosovar Basha, Durim Abdullahu etj.

Punimet e botuara në këtë revistë trajtojnë çështje të ndryshme nga e kaluara jonë. Kryesisht renditja e punimeve është bërë sipas fushave historike, duke filluar nga periudha më e vjetër e deri te periudha më e re. Nuk mungojnë as shkrimet për personalitete të ndryshme të historisë sonë kombëtare, shënimi i datave me rëndësi për të kaluarën tonë, trajtimi i problematikave të ndryshme shoqërore, si kryengritjeve; janë përfshirë gjithashtu edhe aspekte të diplomacisë etj. Trajtimi i problematikave historike, që lidhen me identitetin tonë, përbënte një prioritet të secilës prej redaksive të revistës.

Disa nga tematikat e trajtuara, gjatë këtij pesëdhjetëvjeçari, sipas periudhave historike, ishin edhe këto:

Periudha e Antikitetit kishte në fokus paraardhësit e shqiptarëve gjatë kësaj periudhe, fiset ilire, simbolet tek ilirët, kryesisht ilirët e Jugut, rolin e shtetit ilir, dardanët dhe prejardhjen e tyre, shtrirjen e dardanëve etj.

Periudha e Mesjetës trajtonte probleme që kishin të bënin me popullsinë shqiptare dhe veçmas atë të Kosovës gjatë Mesjetës, qytetet në Kosovë gjatë periudhës osmane, lëvizjet dhe shpërnguljet e popullsisë, qytetet shqiptare nën sundimin e Venedikut, Durrësin, Ulqinin, Janjevën në Mesjetë, epokën e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut dhe luftërat e tij etj.

Periudha e Rilindjes Kombëtare. Nga kjo periudhë janë trajtuar çështjet si: periodizimi i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, shpërngulja e shqiptarëve nga sanxhaku i Nishit, shqiptarët gjatë Tanzimatit, marrëdhëniet shqiptaro-greke, shqiptaro-serbe dhe ato shqiptaro-malazeze, Paqja e Shën Stefanit, Kongresi i Berlinit, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Lidhja Shqiptare e Pejës, kryengritjet shqiptare të viteve 1910-1912, Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë etj.

Periudha e re dhe më e re. Në këtë periudhë studiuesit janë përqendruar te çështjet si: Kosova dhe shqiptarët nën sundimin austro-hungarez dhe bullgar, Konferenca e Ambasadorëve në Londër më 1913, Konferenca e Paqes në Paris më 1919, shqiptarët gjatë Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllovene, periudha e Italisë fashiste të shqiptarët, pushtimi nazist në Kosovë, Konferenca e Bujanit, Organizata Nacional Demokratike Shqiptare etj.

Përfundime

Duke përcjellë rrugëtimin gjysmëshekullor të serisë historike të kësaj reviste, mund të thuhet se kjo revistë ka kaluar nëpër tri faza. Pra, sipas mendimit tonë, ato janë të lidhura ngushtë edhe me rrethanat shoqërore e politike nëpër të cilat ka kaluar populli i Kosovës, e rrjedhimisht edhe Instituti Albanologjik dhe të gjitha organet vartëse të këtij institucioni, e në këtë rast edhe revista “Gjurmime albanologjike” - seria e shkencave historike.

Faza e parë, përfshin periudhën nga numri i parë e deri te numri i njëzetë. Kjo përkon me rithemelimin e këtij institucioni dhe mund të thuhet se gjatë kësaj periudhe nuk mungonte përkrahja institucionale për të. Të tria seritë e revistës kishin numrin serik ndërkombëtar të publikimeve shkencore (ISSN) dhe një fond të veçantë financiar për to. Punimet studimore ishin të pajisura me rezyme në gjuhë të huaj, fillimisht në frëngjisht dhe më vonë në anglisht. Gjithashtu, në këtë periudhë kemi ngritjen e kuadrit profesional, ku disa nga punonjësit shkencorë kishin përfunduar studimet e doktoraturës, ndërsa disa të tjerë kishin kryer specializime jashtë vendit. Kjo mundësoi që të kemi prurje me interes në fushën e historisë në këtë periudhë.

Faza e dytë, përfshin periudhën nga numri njëzetënjë e deri në vitin 1999. Kjo fazë ishte ndër më të vështirat e funksionimit të Institutit Albanologjik, e rrjedhimisht edhe e botimit të “Gjurmimeve

albanologjike”. Suprimimi i autonomisë së Kosovës, largimi i dhunshëm i punonjësve të këtij institucioni nga objekti ku zhvillonin veprimtarinë e tyre shkencore, në mars të vitit 1994, si dhe vendosja e tyre në një ndërtesë të vogël private, keqtrajtimi i punonjësve shkencorë nga pushtuesi etj., përbënin sfida jashtëzakonisht të vështira. Duhet thënë se në këtë kohë nuk kishte as financim të rregullt për veprimtari shkencore dhe as për daljen e botimeve. Falë punës së madhe të drejtuesve të Institutit Albanologjik dhe veçmas të drejtorit të asaj kohe, prof. dr. Sadri Fetiut, revista “Gjurmime albanologjike”, duke përfshirë të gjitha seritë, doli rregullisht. Krahas punonjësve, bashkëpunëtorëve dhe redaksisë një mirënjohje të madhe meritojnë të gjithë donatorët anëmbanë Kosovës që ndihmuan të ruhej vazhdimësia e kësaj reviste edhe në kohën e rrezikimit të qenies fizike shqiptare.

Faza e tretë vazhdon nga viti 2000 e deri në ditët e sotme. Ajo karakterizohet me vendosjen e administratës ndërkombëtare në Kosovë, largimin e forcave serbe, rikthimin në objekt të punonjësve shkencorë, shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, miratimin e akteve ligjore për shkencën, përmirësimin gradual të pozitës së punonjësve shkencorë etj., të cilat bënë që kjo fazë të jetë më e favorshme për të zhvilluar veprimtarinë punonjësit e këtij institucioni. Hulumtimet jashtë vendit, qasja në platforma digjitale të hulumtimit etj., mundësuan që edhe rezultatet e publikimeve në këtë revistë, në masë të konsiderueshme, të jenë të kënaqshme.

Duke përfunduar, themi se revista, me gjithë ngritjet dhe rëniet e saj, ka mundur t’i bëjë të njohura arritjet e punonjësve shkencorë të Institutit, por edhe të historiografisë shqiptare përgjithësisht. Marrë në përgjithësi, kontributet shkrimore, të publikuara në faqet e revistës “Gjurmime albanologjike” - seria e shkencave historike, janë për t’u vlerësuar. Të gjitha premisat e gjertanishme tregojnë se tradita gjysmëshekullore e kësaj ndërmarrjeje të rëndësishme shkencore do të vazhdojë edhe më tutje, duke aplikuar formate bashkëkohore të publikimeve dhe kjo na bën të ndihemi krenarë.